



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2003/4 prot.

Datë 04/09/2023

V E N D I M

Nr. 838/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/09/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73933-06-29-2023, me objekt: “*Blerje elemente të përgatitur hekur – betoni (2 lote)*”, me fond limit 21.728.015,70 leke, loti 1 me Nr. REF-73945-06-29-2023, me objekt: “*Blerje veshje nëntokësore varri*”, me fond limit 14.024.340,60 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 21.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK me NIPT: K11507003S dhe adresë: *Rruga ‘Bardhok Biba’, Pallati TREMA, Hyrja C, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Funerale
Adresa: Rr. “Durrësit”, nr.132, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -
19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73933-06-29-2023, me objekt: “Blerje elemente të përgatitur hekur – betoni (2 lote)”, me fond limit 21.728.015,70 leke, loti 1 me Nr. REF-73945-06-29-2023, me objekt: “Blerje veshje nëntokësore varri”, me fond limit 14.024.340,60 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 21.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

II.2. Më datë 21.07.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 03.08.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “THEOS” shpk	11.115.000 leke	skualifikuar
2. “Dajti Park 2007” shpk	11.473.800 leke	skualifikuar
3. “VELLEZERIT KUKA” shpk	13.035.500 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 03.08.2023, operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Në DST në pikën 2.3 të Kapacitetit teknik përcaktohet se: 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30% (vlera 4,207,302.18 lekë) e fondit limit të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë). Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: - Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. - Për sa më sipër, operatori ekonomik nuk e plotëson këtë kriter ,pasi si dëshmi për përvojën e ngjashme ka paraqitur tre kontrata me objekt “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës”, “Ndërtim i rrugëve Pavaresia, Pashko Vasa, Pishtarët e Demokracisë, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai” të lidhura me Bashkinë e Kamzës dhe “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të sipërme dhe rikualifikim i shesheve”. Kontratat e paraqitura rezultojnë kontrata me objekt të ndryshëm nga objekti i prokurimit “Mall”, Loti 1: “Blerje veshje nëntokësore varri”. ”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 10.08.2023 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Sinder AB” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 15.08.2023, operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2003/2 prot, datë 16.08.2023.

II.8. Me shkresën nr. 503/40 prot, datë 21.08.2023 me objekt: “Njoftim i vendimit nr. 503/38 prot, datë 21.08.2023 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës”, protokolluar me tonën me nr. 2003/3 prot datë 22.08.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit,

në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës, ku ndër të tjera ka argumentuar se: “... Lidhur më pretendimin e ngritur në ankesë, Konisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se:

Në Dokumentat Standarte të Tenderit, në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik është përcaktuar se.

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30% (vlera 2,311,102.53 lekë) e fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë). Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

...

- Përsa më sipër, operatori ekonomik nuk e plotëson këtë kriter, pasi si dëshmi për përvojën e ngjashme ka paraqitur tre kontrata punime ndërtimi dhe jo kontrata për mallra. Dhe konkretisht kontratat e paraqitura për përvojë të ngjashme janë: “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës”, “Ndërtim i rrugëve Pavarësia, Pashko Vasa, Pishtarët e Demokracisë, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai” të lidhura me Bashkinë e Kamzës dhe “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”.

Sipas nenit 77 pika 3 dhe 4 e Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurim Publik”, kualifikimi i operatorëve ekonomik bëhet nëse ata plotësojnë të gjitha kërkesat dhe kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, që lidhen me kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndja ekonomike financiare dhe kapacitet ligjor.

Kontratat e paraqitura rezultojnë kontrata me objekt të ndryshëm nga objekti i prokurimit “Mall”, Loti 1 “Blerje veshje nëntokësore varri” dhe faturat e shitjes janë fatura për punime situacioni, pra nuk janë fatura për përvojë të ngjashme të parashikuar në DST.

Kjo për arsye se nga Autoriteti Kontraktor kërkohet vetëm sigurimi i mallit, pasi pas magazinimit vendosja e tyre kryhet me fuqinë punëtore në dispozicion të këtij autoriteti.

Të gjitha punimet e betonit të paraqitura nga operatori ekonomik në përvojat e ngjashme janë zëra pune të situacionuara sipas Manualeve të Ndërtimit për punime ndërtimi dhe jo mall.

Faturat tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik për përvojë të ngjashme paraqesin vlerat e situacioneve të punimeve të ndërtimit dhe jo të mallit ku sipas DST kërkohet për këto fatura të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, nga Autoriteti Kontraktor na u vu në dispozicion kërkesa e tij drejtuar Bashkisë Tiranë me nr. 617 prot., datë 27.07.2023, ku i kërkohet që në procedurën e prokurimit të fituar nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” Sh.p.k “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë” nëse ka të angazhuar mjetin e transportit si më poshtë:

Kamion me targa AA841KJ

Automjeti është deklaruar nga ky operator ekonomik për tu angazhuar në kontratën e objektit: “Blerje elementë të përgatitur hiekur -betoni (2 LOTE)” është 21,728,015.70 (njëzet e një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e pesëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në përgjigje të kësaj kërkesë Bashkia Tiranë me shkresën nr. 27220/1 prot., datë 02.08.2023, protokolluar pranë Agjencisë së Shërbimeve Funerale me nr.617/1 prot., datë 07.08,2023 konfirmon që mjeti i mësipërm është i angazhuar në kontratën “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë”.

Nga ana e operatorit ekonomik është deklaruar që ky mjet nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Bazuar në nenin 76 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kriteret detyruese për skualifikim, paragrafi (ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.”.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes ”Dajti Park 2007” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: “Në përmbushje të pikës 2.3 të Kapacitetit teknik përcaktohet se si dëshmi për përvojën e ngjashme kemi paraqitur tre kontrata me objekt “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës”, “Ndërtim i rrugëve Pavarësia, Pashko Vasa, Pishtarët e Demokracisë, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai” të lidhura me Bashkinë e Kamzës dhe “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”.

1. Kontratën me nr.prot 3363/3, datë 11.02.2022 me Bashkinë Tiranë “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”, sipas situacionit përfundimtar dhe faturave tatimore të paraqitura janë si më poshtë:

A-2 Punime në Trup të Rrugës

7 Struktura të holla monolite betoni C25/30 është në shumën 6.442.617 lekë

8 F/V Hekur periodik $d < 12$ mm 3.433.437 lekë

D-Punime për ndërtimin e ndrçimit rrugor

18 FV Beton M 100 për veshje tubacionesh 40.950 lekë

19 FV Beton M 200 për fiksimin e shtyllave 107.310 lekë

2. Kontratën me nr.prot 9452, datë 17.10.2022 me Bashkinë Kamëz “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës – Bathore 7”, sipas situacionit përfundimtar dhe faturave tatimore të paraqitura janë si më poshtë:

PUNIME RRUGE

9. Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni)

PUNIME TROTUARE (1.1+1.1 m)

4. FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm 1.255.273 lekë

5. Beton për fiksion bordure C16/20 123.000 lekë

6. Shtresë betoni $t=10$ cm trotuari 19.200 lekë

3. Kontratën me nr.prot 8756, datë 29.09.2022 me objekt “Ndërtim i rrugëve Pavarësia, Pashko Vasa, Pishtarët e Demokracisë, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai”, sipas situacionit përfundimtar dhe faturave tatimore të paraqitura janë si më poshtë:

OBJEKTI: Ndërtim “Pavarësia e Kosovës” Kamëz 2

PUNIME NE RRUGE

8. Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni) 360.990 lekë

9. FV Hekur betoni i zakonshëm $\emptyset > 10$ mm 83.000 lekë

PUNIME NE KUB

5. Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-200 51.000 lekë

6. Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize 91.000 lekë

PUNIME TROTUARE (2*1 m)

1. FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm 2.080 lekë

2. Beton per fiksion bordure C16/20 1.200 lekë

OBJEKTI: Ndërtim “Pashko Vasa” Kamëz 2**PUNIME NE RRUGE**

8. Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni)	488.520 lekë
10. FV Hekur betoni i zakonshëm $\varnothing > 10$ mm	118.000 lekë

PUNIME NE KUB

5. Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-200	55.125 lekë
6. Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize	52.000 lekë

PUNIME NE K.U.N

6. Pusetë shkarkimi b/a 80x80 cm, h=150 cm	81.000 lekë
--	-------------

PUNIME TROTUARE (2*1 m)

1. FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm	1.040 lekë
2. Beton per fiksime bordure C16/20	600 lekë

OBJEKTI: Rikonstrukcion “Mustafa Qemal Ataturku” Kamëz 2**PUNIME NE KUB**

5. Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20	123.750 lekë
6. Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize	130.000 lekë

PUNIME TROTUARE (2x1+bankinë betoni variable)

1. FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm	120.640 lekë
2. Beton per fiksime bordure C16/20	69.600 lekë
3. Shtresë betoni trotuari	236.842 lekë

OBJEKTI: Rikonstrukcion “Athina” Kamëz 2**PUNIME NE KUB**

5. Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20	95.625 lekë
6. Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize	117.000 lekë

PUNIME TROTUARE (2x0.5 variable)

8. FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm	114.400 lekë
9. Beton per fiksime bordure C16/20	41.250 lekë
3. Shtresë betoni trotuari	324.058 lekë

OBJEKTI: Rikonstrukcion “Dubai” Kamëz 2**PUNIME NE KUB**

5. Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20	135.000 lekë
6. Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize	182.000 lekë

Sipas Specifikimeve teknike malli që kërkohet është i përbërë nga:

1. Betoni i markës M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri $\varnothing 6$ mm
2. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400N/mm^2 \leq F_{yk} \leq 600N/mm^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt.

Të cilat do të armohen sipas projektit:

- 4 cope pllaka (anësore) me permasa 42x103x4cm dhe zgare hekuri $\varnothing 6$ mm;
- 4 cope pllaka (kapak) me permasa 52x80x4cm dhe zgare hekuri $\varnothing 6$ mm;
- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 42x80x4cm dhe zgare hekuri $\varnothing 6$ mm;
- dhe
- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 30x105x4cm dhe zgare hekuri $\varnothing 6$ mm;

- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 30x50x4 dhe zgare hekuri Ø6mm;
- 2 cope pllaka (kapak) me permasa 50x55x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;

Pra një proces teknologjik prodhimi bazik dhe i realizueshëm lehtësisht nga ana jonë të provuar nga punët e ngjashme që kemi paraqitur dhe eksperiencës së stafit për realizimin e me sukses të këtij projekti. Zërat e marrë një e nga një të realizuar nga ana jonë tek punët e ngjashme tregojnë që janë të ngjashme me objektin dhe duke e tejkaluar me shumëfish vlerën e kërkuar pikërisht për të siguruar dhe garantuar autoritetin kontraktor që kemi kapacitete teknike për realizimin me sukses të punës së kërkuar duke siguruar mbi të gjitha cilësinë dhe gjithashtu me çmim më të ulët çka sjell dhe mirëpërdorimin e fondeve publike.

Sa më sipër kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik.
2. Pezullimin e procedurës deri në përfundim të shqyrtimit nga çdo hallkë e parashikuar në LPP dhe pranimin e ankesës duke rivlerësuar ofertën e paraqitur nga shoqëria “DAJTI PARK 2007” sh.p.k.
3. Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “DAJTI PARK 2007” sh.p.k duke e kualifikuar atë si ofertë të suksesshme.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**”, Loti 1 “**BLERJE VESHJE NËNTOKËSORE VARRI**”, të dokumenteve të tenderit të “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti Teknik*”, pika 2.3.1 është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30% (vlera 4,207,302.18 lekë) e fondit limit të lotit 1/shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

III.1.2. Në Shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**”, Loti 1 “**BLERJE VESHJE NËNTOKËSORE VARRI**”, të dokumenteve të tenderit të autoriteti kontraktor ka përcaktuar specififikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

1. LOTI 1 VESHJE NËNTOKËSORE VARRI SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Një komplet veshje nëntokësore për të rritur përbëhet nga:

- 4 cope pllaka (anësore) me permasa 42x103x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;*
- 4 cope pllaka (kapak) me permasa 52x80x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;*
- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 42x80x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;*

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri Ø6mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

2. Një komplet veshje nëntokësore për të mitur përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 30x105x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;*
- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 30x50x4 dhe zgare hekuri Ø6mm;*
- 2 cope pllaka (kapak) me permasa 50x55x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;*

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri Ø6mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

Skicimet për veshje nëntokësore varri do të jenë bashkëlidhur DST

2. LOTI 2 BORDURA PROVIZORE VARRI SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Një komplet bordura per te rritur me beton përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 30(10)x180x4cm dhe hekur;*
- 1 cope pllakë (ballore) me permasa 20x80x4cm dhe hekur;*
- 1 cope pllakë (fundore) me permasa 10x80x4cm dhe hekur;*
- 1 cope pllakë (kapak) me permasa 20x80x4cm dhe hekur;*

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe hekur Ø12mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

2. Një komplet bordura për të mitur përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 15 (10)x70x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (ballore) me permasa 20x40x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (fundore) me permasa 10x40x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (kapak) me permasa 15x40x4cm dhe hekur;

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe hekur Ø12mm. Armatura e hekurit është çelik S 500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

Skicimet për bordure provizore varri do të jenë bashkëlidhur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.1.3. Nga shqyrtimi i procesverbalit i datës 29.06.2023 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” konstatohet se hartimin dhe vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit objekt ankimimi, si dhe hartimin dhe vendosjen e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të po këtyre dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor i ka argumentuar si në vijim: “**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, neni 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% (vlera 4,207,302.18 lekë) të vlerës së fondit limit të lotin 1/shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi të secilit lot, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë

tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.”.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

“1. Kontratën me nr.prot 3363/3, datë 11.02.2022, të lidhur nga ana e bashkimit të përkohshëm të shoqëri “Dajti Park 2007 SHPK & SENKA SHPK” (ku shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK ka realizuar 49.9% të vlerës së punimeve dhe shoqëria “SENKA” SHPK ka realizuar 51.1 % të vlerës së punimeve) me Bashkinë Tiranë, me objekt: “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”, me vlerë 46.956.701,40 lekë pa-TVSH, me afat 6-muaj kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Vlerësimi
- Kontratë bashkëpunimi i bashkimit të përkohshëm të dy shoqërive nr. 9375 rep, datë 07.12.2021, ku ndër zërat e punimeve që ka marrë përsipër janë dhe zërat si më poshtë:
 - **A-2 Punime në Trup të Rrugës**
 - 7 Struktura të holla monolite betoni C25/30 është në shumën
 - 8 F/V Hekur periodik $d < 12$ mm
 - **D-Punime për ndërtimin e ndrçimit rrugor**
 - 18 FV Beton M 100 për veshje tubacionesh
 - 19 FV Beton M 200 për fiksimin e shtyllave
- Situacion nr.1 (progresiv) për periudhën 11 shkurt 2022 – 30 maj 2022, me vlere 20.196.566,4 leke.
- Faturë elektronike tatimore nr. 266/2022, datë 09.06.2022, lëshuar nga shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK për Bashkinë Tiranë, me objekt: “Situacion ndërtimi, Situacion nr. 1, Ibë e Sipërme”, me vlerë 20.196.566 leke me-TVSH.
- Situacion përfundimtar për periudhën 11 shkurt 2022 – 10 gusht 2022, me vlere 36.151.120,06 leke.
- Situacion i fondit rezerve, datë 10.08.2022, me vlere 2.682.884,6 leke.
- Akt-Kolaudimi me objekt: “Ndërtim i rrugëve të brendshme Ibë e Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”, datë 10.10.2022.
- Procesverbal i marrjes në dorëzim (përkohshme) për objektin: “Ndërtim i rrugëve të brendshme Ibë e Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”, datë 10.10.2022.

2. Kontratën me nr.prot 8756, datë 29.09.2022, të lidhur midis shoqërisë “Dajti Park 2007” SHPK dhe Bashkisë Kamëz, me objekt: “Ndërtim i rrugëve (Rr. “Panvarësia e Kosovës”+Rr “Pashko Vasa”+Rr “Pishtarët e Demokracisë”+Rr “Mustafa Qemal Ataturku”+Rr. “Dubai”) Kamëz 2”, me vlerë 37.572.965,50 lekë pa-TVSH, me 152 dite pune nga data e pajisjes me leje ndërtimi, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Vlerësimi
- Situacion nr.1, me vlere 18.744.031 leke pa-TVSH.
- Faturë elektronike tatimore nr. 48/2023, datë 28.02.2023, lëshuar nga shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK për Bashkinë Kamëz, me objekt: “Situacion nr.1 ndërtimi

rrugët pavarësia e kosovës, pashko vasa, pishtarët e demokracisë, m.q.ataturk, dubai-kamëz”, me vlerë 18.744.031 leke pa-TVSH.

- *Situacion përfundimtar, me vlere 37.572.855 leke pa-TVSH.*
- *Faturë elektronike tatimore nr. 102/2023, datë 20.04.2023, lëshuar nga shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK për Bashkinë Kamëz, me objekt: “Situacion përfundimtar ndërtimi rrugët pavarësia e kosovës, pashko vasa, pishtarët e demokracisë, m.q.ataturk, dubai”, me vlerë 18.828.824 leke pa-TVSH.*
- *Akt-Kolaudimi për objektin: “Ndërtim i rrugëve (Rr. “Panvarësia e Kosovës”+”Rr “Pashko Vasa”+Rr “Pishtarët e Demokracisë”+Rr “Mustafa Qemal Ataturku”+Rr. “Dubai”) Kamëz 2”, datë 19.04.2023.*
- *Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin: “Ndërtim i rrugëve (Rr. “Panvarësia e Kosovës”+”Rr “Pashko Vasa”+Rr “Pishtarët e Demokracisë”+Rr “Mustafa Qemal Ataturku”+Rr. “Dubai”) Kamëz 2”, datë 20.04.2023.*

3. Kontratën me nr.prot 9452, datë 17.10.2022, të lidhur midis shoqërisë “Dajti Park 2007” SHPK dhe Bashkisë Kamëz, me objekt: “Ndërtimi rruga ‘Kongresi i Dibrës’ ”, me vlerë 20.272.300 lekë pa-TVSH, me 84 dite pune nga data e pajisjes me leje ndërtimi, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- *Formular Vlerësimi*
- *Situacion përfundimtar përmbledhës, me vlere 24.326.479,91 leke.*
- *Faturë elektronike tatimore nr. 70/2023, datë 28.02.2023, lëshuar nga shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK për Bashkinë Kamëz, me objekt: “Situacion ndërtimi, rruga kongresi i dibrës, kamëz”, me vlerë 20.272.066,49 leke pa-TVSH.*
- *Akt-Kolaudimi për objektin: “Ndërtim i rrugës ‘Kongresi i Dibrës’ ”, datë 28.02.2023.*
- *Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin: “Ndërtim i rrugës ‘Kongresi i Dibrës’ ”, datë 10.03.2023.”.*

III.1.5. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se: “... Lidhur më pretendimin e ngritur në ankesë, Konisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se:

Në Dokumentat Standarte të Tenderit, në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik është përcaktuar se.

*1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 30% (vlera 2,311,102.53 lekë) e fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë).** Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

-Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

...

- Përsa më sipër, operatori ekonomik nuk e plotëson këtë kriter, pasi si dëshmi për përvojën e ngjashme ka paraqitur tre kontrata punime ndërtimi dhe jo kontrata për mallra. Dhe konkretisht kontratat e paraqitura për përvojë të ngjashme janë: “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës”, “Ndërtim i rrugëve Pavarësia, Pashko Vasa, Pishtarët e Demokracisë, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai” të lidhura me Bashkinë e Kamzës dhe “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të Sipërme dhe rikualifikim i shesheve”.

Sipas nenit 77 pika 3 dhe 4 e Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurim Publik”, kualifikimi i operatorëve ekonomik bëhet nëse ata plotësojnë të gjitha kërkesat dhe kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, që lidhen me kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndja ekonomike financiare dhe kapacitet ligjor.

Kontratat e paraqitura rezultojnë kontrata me objekt të ndryshëm nga objekti i prokurimit “Mall”, Loti 1 “Blerje veshje nëntokësore varri” dhe faturat e shitjes janë fatura për punime situacioni, pra nuk janë fatura për përvojë të ngjashme të parashikuar në DST.

Kjo për arsye se nga Autoriteti Kontraktor kërkohet vetëm sigurimi i mallit, pasi pas magazinimit vendosja e tyre kryhet me fuqinë punëtore në dispozicion të këtij autoriteti.

Të gjitha punimet e betonit të paraqitura nga operatori ekonomik në përvojat e ngjashme janë zëra pune të situacionuara sipas Manualeve të Ndërtimit për punime ndërtimi dhe jo mall.

Faturat tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik për përvojë të ngjashme paraqesin vlerat e situacioneve të punimeve të ndërtimit dhe jo të mallit ku sipas DST kërkohet për këto fatura të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është

ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë

operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga analizimi dhe krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, me preventivin dhe specifikimet teknike të produkteve objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrën e produkteve objekt të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar preventivit të produkteve objekt-prokurimi, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar blerjen e 2 (dy) lloj produktesh, me sasi dhe volume respektive në funksion të realizimit të projektit. Gjithashtu, referuar specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit, KPP konstaton se për të 2 (dyja) llojet e produkteve objekt-prokurimi janë përcaktuar të njëjtat specifikime teknike, si në vijim: *“Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri Ø6mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400N/mm^2 \leq F_{yk} \leq 600N/mm^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.”*. Në rastin konkret, KPP gjykon, se nuk kemi të bëjmë me realizimin e punimeve standarte ndërtimore civile, por me furnizimin e 2 (dy) lloje produktesh të ndryshme për nga përmasat, por identike për nga specifikimet teknike, dhe për më tepër që referuar këtyre specifikimeve produktet finale të kërkuar për tu prokuruar janë rrjedhojë e një procesi punimi që ka në strukturën e tij materialet e nevojshme për realizimin e këtij produkti (betonin dhe zgara e hekurit) koston e transportit të materialeve dhe koston e fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e tyre. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me furnizimin e 2 (dy) produkteve që në përbërjen e tyre kanë beton dhe zbarë celiku për të siguruar fortësinë e tyre, përfshirë procesin e përgatitjes dhe periudhën e stazhionimit.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim *për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor,

diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për furnizimin me mallra ligjvënësi në nenin 40 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter mund të përmbushet me dorëzimin e dëshmisë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet dhe të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të sipërpërmendur të dorëzuar dëshmon, se ka kryer punime ndërtimore civile si në vijim: “ndërtim rruge, rikualifikim sheshesh”, ku referuar situacioneve të dorëzuara konstatohet se ka kryer punime betoni si në vijim: “*Struktura të holla monolite betoni C25/30 është në shumën; F/V Hekur periodik $d < 12$ mm; FV Beton M 100 për veshje tubacionesh; FV Beton M 200 për fiksimin e shtyllave; Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni); FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm; Beton për fiksion bordure C16/20; Shtresë betoni $t=10$ cm trotuari; Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni); FV Hekur betoni i zakonshëm $\varnothing > 10$ mm; Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-200; Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize; FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm; Beton për fiksion bordure C16/20; Mure betoni C12/15 (themel, xokol betoni); FV Hekur betoni i zakonshëm $\varnothing > 10$ mm; Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-200; Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize; Pusetë shkarkimi b/a 80x80 cm, $h=150$ cm; FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm; Beton për fiksion bordure C16/20; Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20; Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize; FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm; Beton për fiksion bordure C16/20; Shtresë betoni trotuari; Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20; Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize; FV Bordura betoni e parapërgatitur M-250 15X25 cm; Beton për fiksion bordure C16/20; Shtresë betoni trotuari; Shtresë betoni C 16/20 Kunetë betoni M-c 16/20; Puseta shiu me zgarë 40x60 + kapak gize.*”, duke dëshmuar se disponon eksperiencën e nevojshme për kryerjen e punimeve të betonit dhe të zgarave të çelikut, të cila referuar specifikimeve teknike të produkteve objekt-prokurimi nuk janë të ndryshe nga punimet civile të sipërpërmendura dhe të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes. Produktet e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ngjashme me ato të dëshmuara nga ankimesi me anë të kontratave të sipërcituara, pasi dhe vetë metodologjia e realizimit të produktit final objekt-prokurimi nuk është e ndryshme, referuar specifikimeve teknike, ku konstatohet, se produktet finale janë panele betoni me armaturë çeliku.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë punime civile publike, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës *për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë punë publike me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave ka patur punime të ngjashme në natyrë dhe metodologji me produktet që so të furnizohen objekt-prokurimi. KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i punimeve në situacion apo

faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, rezulton se zërat e punimev të betonit dhe zgarave të hekurit mund të konsiderohet e ngjashme me objektin e prokurimit, pasi referuar VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, struktura e koston së këtyre zërave të punimeve civile përbëhet nga kosto e materialit, nga kosto e punetorisë dhe kosto e transportit të materiale, të nevojshëm për realizimin e punimeve dhe ku totali i këtyre kostove është afërsisht 80% e vlerës së zërit të punimit civil. KPP, pasi e veçoi zërat e punimeve të sipërpërmendura në kontratat e paraqitura nga ana e ankimuesit dhe që konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, vëren se vlera e tyre sipas situacioneve dhe faturave tatimore bashkëngjitur këtyre kontratave në sistem, arrijnë të përmbushin dhe të tejkalojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të produkteve të të ngjashme me objektin e prokurimit, duke e plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë zëra punimesh të cilat kanë në përmbajtjen e tyre produktin final të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të projektit ka furnizimin e paneleve të betonit të armuara me zgarë çeliku. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK me kontratat e dorëzuara në sistem plotëson kriterin kualifikues lidhur me furnizimet e ngjashme.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK qëndron.

III.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjatë shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 503/40 prot, datë 21.08.2023 me objekt: “Njoftim i vendimit nr. 503/38 prot, datë 21.08.2023 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” drejtuar ankimuesit ka shtuar pretendime/arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues, e cilat nuk i është komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO më datë 03.08.2023. Konkretisht është shtuar arsyeja e skualifikimit si në vijim: “Gjatë shqyrtimit të ankesës, nga Autoriteti Kontraktor na u vu në dispozicion kërkesa e tij drejtuar Bashkisë Tiranë me nr. 617 prot., datë 27.07.2023, ku i kërkohet që në procedurën e prokurimit të fituar nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” Sh.p.k “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë” nëse ka të angazhuar mjetin e transportit si më poshtë:

Kamion me targa AA841KJ

Automjeti është deklaruar nga ky operator ekonomik për tu angazhuar në kontratën e objektit: “Blerje elementë të përgatitur hekur -betoni (2 LOTE)” është 21,728,015.70 (njëzet e një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e pesëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në përgjigje të kësaj kërkesë Bashkia Tiranë me shkresën nr. 27220/1 prot., datë 02.08.2023, protokolluar pranë Agjencisë së Shërbimeve Funerale me nr.617/1 prot., datë 07.08,2023 konfirmon që mjete i mësipërm është i angazhuar në kontratën “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë”.

Nga ana e operatorit ekonomik është deklaruar që ky mjet nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Bazuar në nenin 76 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kriteret detyruese për skualifikim, paragrafi (ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë

ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.”.

III.2.1. Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.”.

Në nenin 82 pika 2 të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”.

Në nenin 113, pika, të ligjit nr.162/2020, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar:

“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”.

III.2.2. Në kreun X “Zhvillimi i Procedurave”, neni 101, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se

“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës. Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.”.

Gjithashtu në nenin 94 të të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.”.

Në nenin 102 pika 1 të të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces.”.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (*domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (*rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (*Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave*). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 i ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK, si dhe ka shtuar arsye të re skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.2.4. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyeja e re e skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni Neni 94 i VKM nr.285 datë 19.05.2021 nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236,

datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73933-06-29-2023, me objekt: “*Blerje elemente të përgatitur hekur – betoni (2 lote)*”, me fond limit 21.728.015,70 leke, loti 1 me Nr. REF-73945-06-29-2023, me objekt: “*Blerje veshje nëntokësore varri*”, me fond limit 14.024.340,60 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 21.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK, duke e kualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri